



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	28.12.2022	2	viti god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEPMISHKIC	8544/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1028/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1028/2022 të datës 21.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e hazuar* ankesa me numër A.nr.1028/2022 e datës 21.11.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. *Obligohet* Kryetari i Komunës së Gjakovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme administrative për harmonizimin e koeficientit të nëpunëses civile Leonita Rugova nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës më datë 21.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7249/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër 01-120/01-26181 të datës 17.11.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, lidhur me kërkesën e ankueses për harmonizim të koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7).



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 22.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa më datë 05.12.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7249/2022 të datës 21.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 16.11.2022 të parashtruar nga ankuesja të Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Përgjigjen me numër 01-120/01-26181 të datës 17.11.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Aktin e Emërimit nën shenjën A.E.01-112/02-32700 të datës 27.10.2021; Aktin e Emërimit me nën shenjën A.E.Nr.-01-112/01-37798 të datës 16.12.2021; Aktin e Emërimit nën shenjën A.E.Nr.01/112/01-37824 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/02-37826 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01/37879 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01/112/01-37336 të datës 13.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/102-37477 të datës 14.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01-19993 të datës 11.08.2022; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01-37830 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01-37782 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01-37781 të datës 16.12.2021; Aktin e emërimit nën shenjën A.E.Nr.01-112/01-37893 të datës 16.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7318/2022 të datës 22.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 7650/2022 të datës 05.12.2022; Emalin e datës 05.12.2022 të drejtuar Këshillit; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Burimeve Njerëzore 2"; Listën e pagave për muajin Shtator 2022; Listën e Pagave për muajin Tetor 2022; Emalin me numër të protokollit 5246/2022 të datës 20.12.2022 të drejtuar Këshillit; Përgjigje me numër protokollit 7005/2022 e datës 10.11.2022 nga Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publike; Përgjigjen me numër protokollit 8246/2022 e datës 20.12.2022 nga Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuses është e bazuar, sepse

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjakovës, rrjedhimisht e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me numër 01-112/02/02-32700 të datës 27.10.2021 ushtron pozitën e punës "Zyrtare e Personelit 2", me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Më tej, nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesja më datë 16.11.2022 ka parashtruar kërkesë të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë(6) në shtatë (7). Ndërsa, kjo e fundit përmes përgjigjes me numër 01-120/01-26181 të datës 17.11.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuses për harmonizim të koeficientit me arsyetimin se harmonizimi i pagave është problem në nivel vendi, andaj edhe miratimi i Ligjit të Ri të Pagave do të ishte zgjidhje për të gjithë.

I pakënaqur me përgjigjen e Menaxherit të Burimeve Njerëzore, ankuesja me datë 21.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin që ti bëhet harmonizimi i koeficientit nga koeficienti gjashtë (6) në shtatë (7) pasi që koleget e mijë që janë të kategorisë profesional 2 marrin pagë me koeficient shtatë(7).

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: "Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë". Andaj, mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesja është emëruar në pozitën e punës Zyrtar Personeli 2 me koeficient gjashtë (6) të pagës klasa profesional 2, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 dhe 20.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 2, ka të përcaktuar koeficientin shtatë (7) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankueses për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Për me tepër, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Gjakovës aplikon koeficient të ndryshëm të pagës lidhur me pozitën që hyjnë në kuadër të kategorisë së njëjtë profesionale (profesional 2) gjegjësisht sipas Akt Emërimit me numër të protokollit AE.Nr.01-112/02-37798 të datës 16.12.2021 nëpunësit civil në pozitën Zyrtar për Hapësira Publike profesional 2 ka të përcaktuar koeficient shtatë (7), sipas Akt Emërimit me numër të protokollit AE.Nr.01-112/02-37879 të datës 16.12.2021 nëpunësit civil në pozitën Zyrtar për Promovimin e Turizimit profesional 2 ka koeficient shtatë (7), sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112/02-37336 të datës 13.12.2021 nëpunësit civil ka të përcaktuar koeficient shtatë (7) të pagës, po ashtu sipas akteve të emërimit edhe zyrtaret në pozitën Zyrtar për Shëndetësi, Zyrtar për Infrastrukturë, Zyrtar Ligjor dhe Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim klasa profesional 2 kanë të përcaktuar dhe realizojnë koeficient shtatë (7) të pagës, rrjedhimisht mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë së zbatimi i koeficienteve të ndryshme të pagës për pozitë të kategorisë/klasës së njëjtë të punës brenda institucionit të njëjta punëdhënës paraqet trajtim jo të drejtë dhe diskriminues të ankueses, ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-technikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..." Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit konstaton së në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e tërësishëm të ankesës së ankueses duke i dhënë të drejtë të njëjtës për rregullimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6), në shtatë (7), për pozitën e punës Zyrtar i Personelit 2.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe



nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1028/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses .
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.